

Shtojca 11.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

[13.06.2025]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) : ILVA ELEKTRIK SHPK

Adresa: Tirane Tirane TIRANE MUHAMET GJOLLESH 32/1/1

NIPT : K01607005N

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit:E Hapur

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-48581-05-21-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Blerje elektropompa KUZ

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 21 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 22.05.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike [Buletini nr.27 datë 26 Maj 2025]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ILVA ELEKTRIK SHPK

K01607005N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 14 841 000 (Katermbedhjet milion e teteqind e dyzet e njemije Lek) Lek pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. STELLA SHPK

J87603505T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 14 760 000 (Katermbedhjete milion e shtateqind e gjashtedhjetë mijë) Lek pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. ISEC SHPK

L41309004L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **14 655 750 (katërmëdhjetë milionë gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Leke pa TVSH.**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. STELLA SHPK

J87603505T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme:

Nuk plotëson kriterin teknik kualifikues të pikës 2.3.1. sipas të cilit “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

ose,

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara

në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”, pasi kontratat e paraqitura në sistemin elektronikë kanë objekt të ndryshëm me objektin e procedurës së prokurimit dhe nuk përbëjnë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme. Zërat që bëjnë pjesë në listën e mallrave objekt prokurimi në secilin nga kontratat nuk përbëjnë ngjashmëri.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. ISEC SHPK

L41309004L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e mëposhtme:

1. Nuk plotëson kriterin teknik kualifikues të pikës 2.3.1. sipas të cilit “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

ose,

- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*”, pasi kontratat e paraqitura në sistemin elektronike kanë objekt të ndryshëm me objektin e procedurës së prokurimit dhe nuk përbëjnë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme. Zërat që bëjnë pjesë në listën e mallrave objekt prokurimi në secilën nga kontratat nuk përbëjnë ngjashmëri.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2. Nuk plotëson kriterin teknik kualifikues të pikës 2.5 sipas të cilit “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara Mungon dhe AK nuk është në kushte të vertetojë që Operatori Ekonomik është në gjendje për të plotësuar objektin e prokurimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

3. Nuk plotëson kriterin teknik kualifikues të pikës 2.5 sipas të cilit *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi”*. Katalogu nuk është i ngarkuar në sistemin elektronik.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*.

Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

4. Nuk plotëson kriterin teknik kualifikues të pikës 2.8 sipas të cilit *“Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.*

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe ëbsite i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK. ”.

Oferta teknike e kerkuar ne DST mungon.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **ILVA ELEKTRIK SHPK** me Nr.Nipti **K01607005N** dhe adrese **Tirane Tirane TIRANE MUHAMET GJOLLESH 32/1/1**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **14 841 000 (Katermbedhjet milion e teteqind e dyzet e njemije Lek) Lek pa TVSH** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.